



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 106, datë 19.10.2022

**PËR**

**MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN 1, PJESË PËRBËRËSE E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77, DATË 28.06.2021, I NDRYSHUAR, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.3,5,7, RRUGA "BASHKIMI", PALLATI NR.1, RRUGA "DEMOKRACIA", PALLATI NR. 2/1, RRUGA "PROGRESIT", PALLATI NR. 6, RRUGA "MILLENIUMI" DHE PALLATI NR. 4, RRUGA "MINIERËS", NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit nr. 471/53 prot., datë 17.10.2022 si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,



**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e një shtese në Aneksin 1, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 77, datë 28.06.2021, i ndryshuar, përsa i përket listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin Nr.3,5,7, Rruga “Bashkimi”, Pallati Nr.1, Rruga “Demokracia”, Pallati Nr.2/1, Rruga “Progresit”, Pallati Nr.6, Rruga “Milleniumi” dhe Pallati Nr.4, Rruga “Minierës”, në Njësinë Administrative Manëz, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas tabelës si më poshtë vijon:

<b>Nr.</b>	<b>PRONARI</b>	<b>GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS</b>	<b>STRUKTURA E APARTAMENTIT, QË DO PËRFITOHET</b>
105	FARIJE HALIMI	1	1+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 20.10.2022**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 818 / prot. 2



Durrës, më 26/10 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.106 datë 19.10.2022 :

Për miratimin e një shtese në aneksin nr 1, pjesë përbërëse e VKB Nr 77 dt 28.06.2021, i ndryshuar, përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr 3,5,7, Rruga “Bashkimi”, Pallati nr 1, Rruga “Demokracia”, Pallati nr 2/1 , Rruga ”Progresi”, Pallati nr 6, Rruga “Milleniumi” dhe pallati nr 4, Rruga “Minierës”, në Njësinë Administrative Manëz, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
EMILJAN JANI

